ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Bateri, akumulator, tension, burim.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Trajton lloje të ndryshme të burimeve të rrymës elektrike njëkahore. Shqyrton parimin e punës së baterisë diellore dhe mundësinë e shfrytëzimit të energjisë diellore.

Demonstron eksperimentalisht dhe analitikisht lidhjen e disa shpenzuesve elektrik në varg dhe në qark të degëzuar.

Kriteret e suksesi: Gjen pjesët e baterisë dhe të akumulatorit dhe mëson parimin e punës së tyre.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti shkollor, fletore e punës, fletore, libri i mësuesit, tabelë shkrimi, postera. Mjedise mësimore, si: klasa, laboratore, kabinetet, bateri, një enë me lëngë (elektrolit), akumulatori.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Meqë nxënësit kanë njohuri lidhur me disa nga burimet e rrymës elektrike, atëherë i pyesim se cilat janë burimet e rrymës elektrike dhe njohuritë e marra i shënojmë në tabelë, e pastaj iu sqarojmë historikun e krijimit të baterisë për herë të parë si dhe funksionin e saj, më pastaj iu sqarojmë edhe për akumulatorin si burim i rrymës elektrike dhe parimin e punës së tij. Në pjesën reflektuese mësojmë se sa nxënësit kanë kuptuar nga mësimi i zhvilluar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për punë të pavarur dhe aktivitet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra: Faqe 55 në libër fletore puna fizika 9.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.
Janë arritur rezultatet e synuara!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Ligjet e rrymës elektrike

Njësia mësimore: Energjia dhe fuqia e rrymës elektrike

Rezultatet e fushës kurrikulare 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -7, III- 7.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Energji e rrymës elektrike, punë, fuqi elektrike xhuli, vati.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Dallon shprehjet për energji dhe fuqinë e rrymës elektrike së bashku me njësitë matëse të tyre.

Zgjidhë detyra numerike për rrymë elektrike.

Kriteret e suksesi: Formulon shprehjen për punë, energji dhe fuqi të rrymës elektrike.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti shkollor, fletore e punës, fletore, libri i mësuesit, tabelë shkrimi. Mjedise mësimore, si: klasa.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji, matematika.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Në fillim të orës mësimore bëjmë përsëritjen e njësive mësimore për elektriciteti. E pastaj me ndihmën e formulave që nxënësit i kanë të njohura për intensitet, puna mekanike si dhe tension të rrymës elektrike gjenden formulat për punë, energji dhe fuqi të rrymës elektrike, në fund fare bëjmë reflektimin e njësive mësimore për ta vërtetuar se sa nxënësit e kanë kuptuar atë.

Ndërsa në orën tjetër zgjidhim detyra numerike lidhur me punën, energjinë dhe fuqinë e rrymës elektrike.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim me aktivitet dhe zgjidhje të detyrave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra: Faqe 57, plotësimi i fletores së punës, faqe 22-24.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.

Mendoj që ora ishte e suksesshme!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore:: Fusha magnetike

Njësia mësimore: Magnetët e përhershëm

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës: I-6, II -1, IV – 6

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Magnet, forcë magnetike, poli i veriut, busulla.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Shpjegon fushën magnetike të magnetëve të përhershëm, vijat e fushës magnetike, fluksin dhe induksionin magnetik.

Shqyrton fushën magnetike të Tokës si fushë të magnetit gjigant dhe i krahason vijat magnetike të saj me vijat e shufrës magnetike.

Kriteret e suksesi: Dallon polin e veriut nga ai i jugut si dhe forcat magnetike.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, disa magnet në forma të ndryshme, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mesimore.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji, gjeografi

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Nxënësit kanë njohuri paraprake për magnetët andaj i pyesim se çka dijnë ata për magnetët, të dhënat i shënojmë në tabelë, dhe më pastaj marrim magnetët në forma të ndryshme dhe iu tregojmë nxënësve për polet magnetike, ngjyrosjen e tyre për t'i dalluar ata etj.

Poshtu bëjmë përkufizimin për busullën si dhe mësojmë mënyrën e përdorimit të saj.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm, me anë të aktivitetit dhe punës së pavarur.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra nga libri fizika 9, faqe 63.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.

Janë arritur rezultatet e synuara!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Fusha magnetike

Njësia mësimore: Forca dhe fusha magnetike

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -6, III- 4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Forcë magnetike, fushë magnetike, refuzim, tërheqje.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Shpjegon fushën magnetike të magnetëve të përleshëm, vijat e fushës magnetike, fluksin dhe induksionin magnetik.

Shqyrton fushën magnetike të Tokës si fushë të magnetit gjigant dhe i krahason vijat magnetike të saj me vijat e shufrës magnetike.

Kriteret e suksesi: Përkufizon fushën dhe forcën magnetike.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, disa magnet në forma të ndryshme, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji, gjeografi.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pas përsëritjes së njësisë së fundit mësimore i pyesim nxënësit për njohurit që kanë për forcën magnetike, cilat janë forcat magnetike dhe me ndihmën e magnetëve e gjejmë se kur paraqiten ato.

Tani marrim një copë letër, një magnet në formë shufre e fusim në mes të letrës dhe vendosim pluhur magneti mbi të, për ta vërtetuar kahjen e vijave të fushës magnetike. Vërtetojmë se vijat e fushës magnetike dalin nga poli i veriut dhe hyjnë në polin e jugut, ndërsa te fusha magnetike e Tokës ndodh e kundërta, vijat e fushës magnetike dalin nga poli i jugut dhe hyjnë në atë të veriut.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi vazhdueshëm me anë të aktivitetit dhe punës së pavarur.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra, libri fizika 9, faqe 63.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.
Ora ishte e suksesshme!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Fusha magnetike

Njësia mësimore: Fluksi dhe induksioni magnetik

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës: I-6, II-1, III-7

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Fluks magnetik, induksion magnetik, vija të fushë magnetike.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Shpjegon fushën magnetike të magnetëve të përleshëm, vijat e fushës magnetike, fluksin dhe induksionin magnetik.

Kriteret e suksesi: Përkufizon fluksin magnetik dhe induksionin magnetik dhe i formulon ato.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: matematikë, biologji, gjeografi.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Në fillim të orës mësimore bëjmë përsëritjen e njësisë mësimore për magnetet, pastaj përkufizojmë fluksin magnetik dhe bëjmë formulimin e fluksit dhe induksionit magnetik, gjejmë njësitë e tyre dhe bëjmë lidhshmërinë ndërmjet fluksit dhe induksionit magnetik.

Më pastaj nxënësit mësojmë se në cilin rast induksioni magnetik do të jetë maksimal, kur do të ketë një lloj vlere që varet nga këndi i vijave të fushës magnetike në krahasim me sipërfaqen dhe kur ka vlerë zero.

Tani me përsëritje kuptojmë se sa nxënësit kanë njohuri rreth njësisë mësimore.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim me anë të aktivitetit dhe punës së pavarur.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra në fletore pune, faqe.25-27.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.

Ora ishte e suksesshme, janë arritur rezultatet e synuara!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Fusha magnetike

Njësia mësimore: Fusha magnetike e rrymës elektrike

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -6, IV-6

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Fushë magnetike, elektromagnetike, Ersted.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Demonstron fushën magnetike të rrymës elektrike dhe formën e vijave të përcjellësit drejtvizor, Prezanton vijat e fushës.

Kriteret e suksesi: Mëson se rryma elektrike krijon fushë magnetike.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore, disa përçues, një bateri dhe një magnet në forme të gjilpërës magnetike.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji, TIK.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Shumë vegla pune punojnë me rrymë elektrike, kjo bëhet e mundur falë zbulimeve që janë bërë në shekullin e 19-të, në vitin 1820, ku Ersted vërtetoi se edhe rryma elektrike formon fushë magnetike, pra kur një përçues e lidhim për rrymë elektrike dhe i afrojmë një gjilpërë magnetike do të shohim se gjilpëra do të lëviz. Shkak i lëvizjes së gjilpërës magnetike është forca bashkëvepruese ndërmjet fushës magnetike të rrymës elektrike dhe të fushës magnetike të magnetit.

Ersted erdhi në përfundim se në çdo përçues që rrjedh rryma elektrike formohet fusha magnetike e quajtur fushë elektromagnetike, vetitë e të dyja fushave janë të ngjashme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm, me anë të aktivitetit në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra: bëni përshkrimin e eksperimentit të Erstedit.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.
Janë arritur rezultatet e synuara!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Fusha magnetike

Njësia mësimore: Veprimi i fushës magnetike te përçuesi me rrymë

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -2, II-6, IV-6

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Fushë elektromagnetike, fushë magnetike, veprim, forcë.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Prezanton vijat e fushës magnetike të qarkut rrethor elektrik, solenoidit dhe magnetit të përhershëm në formë shufre.

Kriteret e suksesi: Mëson rregullën e dorës së majtë për përcaktimin e kahjes së lëvizjes së përçuesit në fushë magnetike.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore, disa përçues, një bateri dhe një magnet në formë patkoi.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, TIK.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Për ta vërtetuar bashkëveprimin e fushës magnetike me fushën elektromagnetike merret një magnet në formë patkoi, disa përçues dhe një bateri. Kur përçuesi me rrymë futet në fushën magnetike do të shohim se ai do të zhvendoset (do të futet brenda ose do të dal jashtë magnetit) këtë eksperiment e bëri Amperi.

Se a do të futet brenda apo do të dal jashtë magnetit përçuesi, varet nga kahja e vijave të fushës magnetike dhe nga kahja e rrjedhjes së rrymës elektrike, kjo përcaktohet me rregullën e dorës së majtë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi vazhdueshëm, me anë të aktivitetit dhe punës së pavarur.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra faqe 69, 70.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Ora ishte e suksesshme janë arritur rezultatet e synuara!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Fusha magnetike

Njësia mësimore: Elektromagnetët

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II -7, III- 5, IV-4

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: elektromagnet, fushë magnetike, forcë magnetike.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Prezanton vijat e fushës magnetike të qarkut rrethor elektrik, solenoidit dhe magnetit të përhershëm në formë shufre.
Zgjidhë detyra numerike për veprimin e fushës.

Kriteret e suksesi: Bën dallimin ndërmjet magnetit të përhershëm dhe elektromagnetit dhe përdorimin e tyre në praktikë.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore, disa përçues, një trup (gozhdë) dhe disa copa të vogla hekuri ose magneti.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Meqë nxënësit tani kanë njohuri për fushën magnetike dhe elektromagnetike atëherë marrim disa përçues bakri, i mbështjellim për një gozhdë dhe i lidhim për bateri, ia afrojmë copave të hekurit ose magnetit dhe do të shohim se ky përçues bakri kur e kyqim në rrymë elektrike do t'i tërheqë këto copëza hekuri ose magneti, ndërsa kur e shkyqim rrymën elektrike do t'i lëshojë ato. Më pastaj bëjmë dallimin mes të fushës magnetike dhe elektromagnetike, si dhe mësojmë rëndësinë e tyre në praktikë.

Në orën tjetër mësimore bëjmë zgjidhjen e detyrave lidhur me fluksin magnetik, induksionin magnetik dhe forcën magnetike.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i punës në grupe.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra: Ndërtoni një elektromagnet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.
Ora ishte e suksesshme!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Induksioni Elektromagnetik

Njësia mësimore: Induksioni elektromagnetik (Ligji i Faradeit për induksion elektromagnetik)

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: I-1, II -6, III- 5.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Rrymë elektrike, induksion elektromagnetik, ligji i Faradeit për induksion elektromagnetik.

Rezultati i të nxënësve të orës mësimore:

Demonstron shembuj të ndërrimit të fluksit magnetik për përfitim të rrymës së induktuar.

Demonstron formulimin e ligjit të Faradeit për induksion EM.

Kriteret e suksesi: Shpjegon mënyrën e përfitimit të rrymës elektrike të induktuar.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore, disa përçues, një magnet në formë patkoi, një miliampermetër.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Në fillim të orës mësimore i pyesim nxënësit se si Ersted zbuloi fushën magnetike nga rryma elektrike. Meqë rryma elektrike formon fushë magnetike atëherë të shkenctarët është paraqitur pyetja, a është e mundur e kundërta? Që nga fusha magnetike të fitohet rryma elektrike.

Kësaj pyetje i dha përgjigje Majkëll Faradei në vitin 1831, ku ai bëri të njejtin eksperiment si të Erstedit, mirëpo në vend të baterisë ai lidhi një miliampermetër dhe gjatë lëvizjes së përçuesit me rrymë në fushën magnetike pa që treguesi i miliampermetrit po lëviz herë në një anë e herë në tjetrën.

Faradei erdhi në përfundim se me ndryshimin e vijave të fushës magnetike në çfardo mënyre fitohet rryma elektrike e quajtur induksion elektromagnetik ose rrymë elektrike e induktuar. Më pas bëjmë formulimin e induksionit elektromagnetik dhe gjejmë njësinë e saj.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i punës së pavarur të nxënësve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra nga libri fizika faqe 73.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.

Janë arritur rezultatet e synuara

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Induksioni Elektromagnetik

Njësia mësimore: Rregulla e Lencit për induksion elektromagnetik dhe Vetinduksioni

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-1, II -6, IV – 1.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Rregulla e Lencit, forcë magnetike, vetinduksion.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore:

Demonstron formulimin e ligjit të Faradeit për induksion EM dhe rregullën e Lencit.

Shpjegon induksionin reciprok dhe **demonstron** vetinduksionin.

Kriteret e suksesi: Mëson se rryma e induktuar me forcë e kundërshton shkaktarin e induksionit elektromagnetik.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore, një qark elektrik me një llampë, një induktor dhe një rrezistor.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pas përsëritjes së mësimit për induksionin elektromagnetik atëherë nxënësve iu shpjegojmë se gjatë futjes dhe nxjerrjes së magnetit në bobinë, krijohet rryma elektrike dhe njëkohësisht edhe fusha magnetike e cila do të ketë kahje të kundërt me lëvizjen e magnetit nëpër bobinë, do të thotë gjatë futjes së magnetit në bobinë do të paraqitet forca refuzuese, ndërsa gjatë nxjerrjes forca tërheqëse, e tani bëjmë përkufizimin e rregullës së Lencit për induksion elektromagnetik.

Poshtu me një shembull konkret me mjete mësimore vërtetojmë se gjatë rrjedhjes së rrymës elektrike nëpër përçues formohet fusha magnetike dhe njëkohësisht edhe rryma elektrike, kjo rrymë e vetinduktuar ka kahje të kundërt me qarkullimin e rrymës elektrike, andaj edhe llampa ku kemi bobinë me induktivitet do të ndizet me vonë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim me anë të aktivitetit të nxënësve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra nga libri faqe 73.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.
Ora ishte e suksesshme!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Induksioni Elektromagnetik

Njësia mësimore: Rryma elektrike alternative

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -7, III- 7.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Rryma alternative, bobina, intensiteti, perioda.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore:

Përshkruan gjenerimin e rrymës alternative dhe paraqet vetitë themelore të saj.

Kriteret e sukcesi: Mëson se intensiteti i rrymës alternative për një periodë ndërron kahjen.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore, një bobinë, magnet në formë shufre.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji, matematikë.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pasi kemi bërë përsëritjen e mësimin për induksion elektromagnetik atëherë marrim një bobinë në formë të kornizës dhe një magnet që rrotullohet nëpër bobinë dhe e shqyrtojmë çdo pjesë të periodës së rrotullimit të kornizës në fushën magnetike. Do të vërejmë se gjatë rrotullimit të kornizës me rrymë në fushën magnetike, intensiteti i rrymës elektrike do të ndryshojë vazhdimisht, si dhe do t'i ndryshojë kahja e rrymës elektrike. Me këtë mësojmë se rryma alternative ndërron kahjen dhe intensitetin për një period (rrotullim të plotë).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim me anë punës dhe aktivitetit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra faqe 77.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.
Janë arritur rezultatet e synuara!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Induksioni Elektromagnetik

Njësia mësimore: Gjeneratori dhe elektromotorri

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-1, II -6, IV-6.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Gjenerator, stator, rotor, elektromotorr, brusha.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore:

Përkufizon gjeneratorin dhe elektromotorrin si paisje elektrike, numëron pjesët themelore të elektromotorrit dhe gjeneratorit.

Mëson parimin e punës së elektromotorrit dhe gjeneratorit.

Kriteret e suksesi: Mëson se elektromotorri dhe gjeneratori bëjnë shndërrimin e energjisë mekanike në atë elektrike dhe e kundërta (ligjin e ruajtjes së energjisë).

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore, gjeneratori dhe elektromotorri.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pas përsëritjes së njësisë së fundit mësimore për rrymën alternative. Me pastaj me ndihmën e një gjeneratori dhe një elektromotorri që e kemi si mjet mësimorë bëjmë sqarimin e punës së gjeneratorit dhe elektromotorrit si dhe numërojmë pjesët kryesore të tyre, nga kjo kuptojmë se gjeneratori bënë punë të kundërt nga elektromotorri. Elektromotorri bënë shndërrimin e energjisë elektrike në atë mekanike ndërsa gjeneratori të kundërtën.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim me anë të aktivitetit të zhvilluar në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra: Krijimi i një elektromotorri demonstrues.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.
Ora ishte e suksesshme!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Induksioni Elektromagnetik

Njësia mësimore: Rryma alternative trifazore

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -7, III- 7.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Lidhje në yll, lidhje në trekëndësh, rrymë trifazore.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Dallon lidhjet e rrymës alternative trifazore dhe arsyeton dobinë e kësaj rryme.

Mëson së lidhja në trekëndësh mundëson bartjen e rrymës me tre tela dhe vendoset te prodhuesi, ndërsa ajo në yll vendoset te shpenzuesi e në këtë rast nxirret teli i katërt (zeroja).

Kriteret e suksesi: Mëson arsyen e përdorimit të fazave dhe zeros dhe rëndësinë e saj.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, matematikë, TIK.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Duke e paraqitur grafiksht krijimin e rrymës trefazore më tre bobina nxënësit kuptojnë se në çdo moment shuma algjebrike e intensitetit të rrymës trifazore është e barabartë me zero. Kjo mundëson lidhjen e rrymës trifazore në trekëndësh, e kjo bartjen e rrymës me tre tela. Poashtu rryma trifazore mundëson edhe formimin e lidhjes në yllë, lidhja në yll mundëson formimin e telit të katërt që është faza zero.

Poashtu nxënësit mësojnë se lidhja ndërmjet cilësdo fazë dhe zeros na jep tensionin 220 V, ndërsa lidhja ndërmjet dy fazave na jep tensionin 380 volt.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim me anë të aktivitetit të zhvilluar në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra: faqe 82, libri fizika 9.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.

Ora ishte e suksesshme!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Induksioni Elektromagnetik

Njësia mësimore: Transformatorët elektrik

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -6, II- 7, IV – 6

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Transformator, bobinë primare, bobinë sekondare.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Mëson se për të bërë bartjen e rrymës elektrike pa humbje nevojitet që të bëhet ndryshimi i intensitetit dhe të tensionit dhe se kjo vegël quhet transformator.

Paraqet me formulë raportin ndërmjet tensionit dhe intensitetit si dhe raportin ndërmjet tensionit dhe numrit të dredhave.

Zgjidh detyra numerike lidhur me transformatorët.

Kriteret e suksesit:

Mëson se transformatori ngritës tensioni vendoset te prodhuesi ndërsa transformatori zbritës tensioni te shpenzuesi.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore, transformatori.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, TIK, matematikë.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Tani nxënësit i pyesim për solonoidin, bobinën dhe elektromagnetin, e pastaj i vizatojmë dy bobina njëra afër tjetrës duke e vendosur një magnet në mes, dhe njëra nga këto dy bobina e lidhim më rrymë alternative. Meqë rryma alternative ka intensitet të ndryshuar për një periudë atëherë çdo ndryshim i fushës magnetike në bobinën e parë krijon rrymë elektrike në bobinën e dytë me tension ndryshe nga e para varësisht nga numri i mbështjelljeve.

Tani bëjmë përkufizimin për transformatorin si dhe bëjmë formulimin e intensitetit dhe tensionit duke u bazuar në formulën për fuqi të rrymës elektrike.

Në orën tjetër bëjmë zgjidhjen e detyrave numerike dhe bëjmë krahasimin ndërmjet numrit të mbështjelljeve në bobinën primare dhe sekondare.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim me anë të aktivitetit të zhvilluar në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotësoni librin fletore pune, faqe 28-37.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj.
Janë arritur rezultatet e synuara!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Induksioni Elektromagnetik

Njësia mësimore: Bartja e rrymës alternative nga burimi deri te shpenzuesi

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës: I-1, II -1, IV- 6.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Transformator, ngritës tensioni, zbritës tensioni, lidhje në yll dhe në trekëndësh, gjenerator.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Mëson se për të bërë bartjen e rrymës elektrike pa humbje nevojitet që të bëhet ndryshimi i intensitetit dhe të tensionit dhe se kjo vegël quhet transformator. Paraqet me formulë raportin ndërmjet tensionit dhe intensitetit si dhe raportin ndërmjet tensionit dhe numrit të dredhave. Poashtu mëson për bartjen e rrymës nga largësitë e mëdha, ku nevojiten 3 përçues (faza).

Kriteret e suksesi:

Mëson mënyrën e bartjes së rrymës alternative nga prodhuesi deri te shpenzuesi me humbje sa më të vogla.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri, fletorja, tabela e shkrimit, kabineti, klasa mësimore, disa kablllo të rrymës me 5 dhe 3 fije.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: kimi, biologji, gjeografi.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Meqë nxënësit kanë njohuri për transformatorin dhe përdorimin e tij si dhe për mënyrat e lidhjes së rrymës trefazore atëherë bëjmë shpjegimin e bartjes së rrymës alternative trifazore nga prodhuesi deri te shpenzuesi, nxënësve tani iu skjarojmë se cili transformator vendoset te prodhuesi dhe cila lidhje formohet, dhe cila lidhje dhe cili transformator vendoset të shpenzuesi, cili është roli i fazës zero etj.

Tani marrim një kablllo të rrymës me 3 dhe me 5 përçues dhe iu sqarojmë ngjyrat e izolatorëve të përçuesve dhe rëndësinë e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim me anë të aktivitetit të zhvilluar në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra faqe 86-87.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Gjatë reflektimit kuptojmë për rrjedhën e orës mësimore dhe bëjmë vlerësimin e saj. Janë arritur rezultatet e synuara!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Përhapja drejtvizore e dritës

Njësia mësimore: Burimet e dritës dhe përhapja drejtvizore e dritës

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -8, III- 4.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Dritë, burim i dritës, ligjet e dritës.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore:

Numëron disa burime të dritës, mëson se drita përhapet në mënyrë drejtvizore, mëson për eklipset e dritës dhe hijën dhe gjysmëhijën. Përkufizon ligjet e përhapjes drejtvizore të dritës dhe përpilon formën analitike të tyre.

Kriteret e suksesit: Mëson se si rezultat i përhapjes drejtvizore të dritës formohet hija dhe gjysmëhija, ndërsa si rezultat i pozitës së Tokës, Diellit dhe Hënës formohen eklipset.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesional, materiale tekstuale, etj. Tabelë shkrimi, postera, fotografi, modele, makete etj. Mjedise mësimore si: klasa, laboratore, kabinetet.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: biologji, kimi, gjeografi.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pas përsëritjes së njësive mësimore për valët mekanike mëqë edhe drita është valë si dhe njohuritë që kanë nxënësit nga klasa e gjashtë për dritën atëherë ata i pyesim se çka dinë për dritën dhe valët në përgjithësi, çka dinë për burimet e dritës, për zënien e dritës së Diellit nga Hëna dhe Toka (eklipset) etj.

Pastaj së bashku me nxënës numërojmë ligjet themelore të dritës dhe në pika të shkurtra i përkufizojmë ato. Si dhe iu skjarojmë se si formohen eklipset si formohet hija dhe gjysmëhija etj.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i vazhdueshëm, me anë të aktivitetit mësimor.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra: libri kl. 9, faqe 93.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Tani me përsëritje bëjmë vlerësimin e orës mësimore.

Ora ishte e suksesshme janë aritur rezultatet e synuara!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Përhapja drejtvizore e dritës

Njësia mësimore: Ligji i reflektimit të dritës - Pasqyrat e rrafshta

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -7, IV- 4.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Pasqyrë, reflektim, dritë.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Përkufizon ligjet e përhapjes drejtvizore të dritës dhe përpilon formën analitike të tyre. Përfiton formulat e përcaktimit të pozitës së shëmbëllimeve dhe zmadhimit të tyre në pasqyra të rrafshta, sferike dhe thjerra të holla dhe shpjegon rregullat e përcaktimit të trupave në pasqyrë.

Kriteret e suksesit: Mëson se pasqyrat e reflektojnë dritën dhe si rezultat i dritës së reflektuar në i shohim trupat.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesional, materiale tekstuale, etj. Tabelë shkrimi, postera, fotografi, modele, makete etj. Mjedise mësimore si: klasa, laboratore, kabinetet, pasqyra

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare : biologji, kimi, matematikë.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Në fillim të orës mësimore nxënësit i pyesim për reflektimin e valëve ligjin e reflektimit të valëve, njohuritë që kanë nxënësit rreth valëve, meqë edhe drita është valë.

Pataj marrim një pasqyrë e vendosim në rreze të diellit dhe e masim këndin që ka rënë drita dhe këndin e reflektimit të dritës, poashtu trupin para pasqyrës së rrafsh e afrojmë dhe e largojm, e nga kjo kuptojm se largësia e trupit para pasqyrës dhe prapa pasqyrës është e barabartë, tani para pasqyrës vendosim disa shkronja dhe i pyesim nxënësit se pse disa shkronja janë të kthyera mbrapsht e disa janë në të njejtën formë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i vazhdueshëm me pyetje.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra: faqe 102, libri fizika 9.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (plotësohet pas përfundimit të orës mësimore)

Tani me përsëritje bëjmë vlerësimin e orës mësimore.

Ora ishte e suksesshme!

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore /Lënda: Fizikë, Shkalla e kurrikulës: IV/ Klasa: 9, Data: _____

Tema mësimore: Përhapja drejtvizore e dritës

Njësia mësimore: Pasqyrat sferike

Rezultatet e fushës kurrikulare: 1.3.1, 1.3.2.

Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II -6, III-7.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fjalët kyçe: Pasqyrë sferike, reflektim, konkave, konvekse.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Përkufizon ligjet e përhapjes drejtvizore të dritës dhe përpilon formën analitike të tyre. Përfiton formulat e përcaktimit të pozitës së shëmbëllimeve dhe zmadhimit të tyre në pasqyra të rrafshta, sferike dhe thjerra të holla dhe shpjegon rregullat e përcaktimit të trupave në pasqyrë.

Kriteret e suksesit: Dallon pasqyrën konkave nga ajo konvekse.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesional, materiale tekstuale, etj. Tabelë shkrimi, postera, fotografi, modele, makete etj. Mjedise mësimore si: klasa, laboratore, kabinetet, pasqyra sferike.

Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: biologji, kimi, matematikë.

Jeta dhe puna

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

